



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



PSH.nr.567/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: N.T.P“Aragonit-2”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Grupi i Operatorëve ekonomik: “IBM SH.P.K”: Majlinda Bajraktari B.I - Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me lende djegëse pelet për shkollat fillore dhe te mesme te Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-1449-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, më datën: 17.09.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.T.P“Aragonit-2” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me lende djegëse pelet për shkollat fillore dhe te mesme te Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-1449-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me lende djegëse pelet për shkollat fillore dhe te mesme te Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-1449-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Komuna e Prishtinës, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.T.P“Aragonit-2” - Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues N.T.P“Aragonit-2” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 14.08.2020 me nr. 567/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me lende djegëse pelet për shkollat fillore dhe te mesme te Komunës se Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-20-1449-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 10, 59, 60, dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.08.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.08.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi nr. 1 ; Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues është eliminuar me arsyetimin se ka ofruar kontrata te papërfunduara dhe për arsyen e eliminimit autoriteti kontaktues ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim i ka përmendur te gjitha referencat ne te cilat shënon se “....Furnizimi vazhdon ende”.

Sa i përket arsyes se eliminimit, eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se AK-ja, lidhur me kontratat dhe referencat ka kërkuar:

1. OE-ik duhet te ofroj dëshmi te mjaftueshme se ka përfunduar kontrata për furnizime te ngjashme ne tri vitet e fundit nga koha e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë - në vlerën minimale prej 250.000,00 euro.

Dëshmia: 1. Lista e projekteve të përfunduara në tre vitet e fundit për furnizime te ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave te pranimeve apo edhe me transaksione bankare për furnizimet e bëra.

Duke u bazuar ne kërkesën e lartshënuar, OE ankues ka ofruar listën e kontratave ne te cilën ka dhënë titullin

e kontratës, blerësin, data e nënshkrimit – përfundimit, vlerën e kontratës. Ndërsa si dëshmi ne ofertën e tij ka ofruar referencat për projektet e prezantuara ne listën e kontratave.

Eksperti shqyrtues, sqaron se ne referencat e projekteve për te cilat AK-ja, i ka përmendur ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim (Kontrata me OE Arda Rei Group, Decon, Intercoom, Modesa, Naser Sopjani, Porche, Prince Coffe House, Shpija vjetër, Swiss apartments Prishtina dhe Shtëpiaku), thuhet se “....Furnizimi vazhdon ende”.

Autoriteti kontraktues, gjate vlerësimit te ofertave përmes emali-it te datës: 17.06.2020, i ka kërkuar sqarim OE ankues, lidhur me kërkesën 9.1 dhe 9.2 te FTD-se, i cili ne përgjigje te kërkesës se AK-se i ka dorëzuar disa dëshmi dhe te njëjtat janë dorëzuar përmes emali-it dhe nuk janë ne sistemin e E-prokurimit, prandaj eksperti nuk mund te konstatoj se çfarë dokumente ka dorëzuar për dëshmitë te cilat i ka kërkuar AK-ja sepse janë ngarkuar si doç atach, vetëm se i njëjti i ka shënuar si tituj dëshmitë qe i ofron:

Listën e kontratave.

Referencat.

Kartelat financiare te secilit klientit.

Deklaratën e nen betim.

Eksperti shqyrtues, pasi i ka analizuar shkresat e lendes, sqaron se OE ankues ne ankesën e tij te parashtuar ne OSHP, si prove apo dëshmi ka ofruar kontratat e lidhura me OE Arda Rei Group, Decon, Intercoom, Modesa, Naser Sopjani, Porche, Prince Coffe House, Shpija vjetër, Swiss apartments Prishtina, dhe ne këto kontrata nuk thuhet se këto kontrata janë duke vazhduar, te gjitha kontratat e lartpërmendura kanë një validitet te caktuar, prej/deri.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se ka paqartësi ne këto dëshmi për faktin se ne kontrate thuhet se ka përfunduar ne datën e parapare, ndërsa ne reference thuhet se vazhdon ende.

Eksperti shqyrtues, vlerëson se autoriteti kontraktues, konform nenit 72 dhe 59 te LPP-se, mund ta verifikojë edhe me sakte, tek operatorët ekonomik apo subjektet te cilat i kane lëshuar këto dëshmi.

Prandaj, eksperti shqyrtues, vlerëson se është dashur behet një verifikim me i detajuar lidhur me këto dëshmi edhe për faktin se i njëjti i ka dorëzuar si dëshmi edhe transaksionet bankare për secilin klient e cila njeherit edhe ka qene kërkesë e dosjes se tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Operatori Ekonomik, me datë: 31.08.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se Pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 17.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se operatorit ekonomik ankues N.T.P “Aragonit-2” - Prishtinë, është eliminuar nga autoriteti kontraktues me arsyetimin se ka ofruar kontrata të papërfunduara dhe për arsyen e eliminimit autoriteti kontaktues në vendimin e kërkesës për rishqyrtim i ka përmendur të gjitha referencat në të cilat shënon se “....Furnizimi vazhdon ende”. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK lidhur me kontratat dhe referencat ka kërkuar: 1. OE-ik duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka përfunduar kontrata për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit nga koha e publikimit të këtij Njoftimi për Kontratë - në vlerën minimale prej 250.000,00 euro.

Dëshmia: 1. Lista e projekteve të përfunduara në tre vitet e fundit për furnizime të ngjashme dëshmuar me kopjet e referencave apo certifikatave të pranimeve apo edhe me transaksione bankare për furnizimet e bëra. Gjithashtu, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se duke u bazuar në kërkesën e lartshënuar, OE ankues ka ofruar listën e kontratave në të cilën ka dhënë titullin e kontratës, blerësin, data e nënshkrimit – përfundimit, vlerën e kontratës. Ndërsa si dëshmi në ofertën e tij ka ofruar referencat për projektet e prezantuara në listën e kontratave.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në referencat e projekteve për të cilat AK i ka përmendur në vendimin e kërkesës për rishqyrtim (Kontrata me OE Arda Rei Group, Decon, Intercoom, Modesa, Naser Sopjani, Porche, Prince Coffe House, Shpija vjetër, Swiss apartments Prishtina dhe Shtëpiaku), thuhet se “....Furnizimi vazhdon ende”. Autoriteti kontraktues, gjatë vlerësimit të ofertave përmes emali-it të datës: 17.06.2020, i ka kërkuar sqarim OE ankues lidhur me kërkesën 9.1 dhe 9.2 të FTD-se, i cili në përgjigje të kërkesës së AK-se i ka dorëzuar disa dëshmi dhe të njëjtat janë dorëzuar përmes emali-it dhe nuk janë në sistemin e E-prokurimit. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron nuk mund të konstatoj se çfarë dokumente ka dorëzuar për dëshmitë të cilat i ka kërkuar AK-ja sepse janë ngarkuar si doc attach, vetëm se i njëjti i ka shënuar si tituj dëshmitë që i ofron:

Listën e kontratave, Referencat, Kartelat financiare të secilit klientit, Deklaratën e nen betim.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues ne ankesën e tij të parashtruar në OSHP, si prova apo dëshmi ka ofruar kontratat e lidhura me OE Arda Rei Group, Decon, Intercoom, Modesa, Naser Sopjani, Porche, Prince Coffe House, Shpija vjetër, Swiss apartments Prishtina, dhe në këto kontrata nuk thuhet se këto kontrata janë duke vazhduar, të gjitha kontratat e lartpërmendura kanë një validitet të caktuar, prej/deri. Andaj ka paqartësi në këto dëshmi për faktin se në kontrate thuhet se ka përfunduar me datën e parapare, ndërsa në reference thuhet se vazhdon ende.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion si dhe në sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, andaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së të kërkoj sqarime shtesë nga OE ankues lidhur me këto kontrata dhe të ju bëhet një shqyrtim-analizë me e detajuar këtyre dëshmive pasi që i njëjti i ka dorëzuar si dëshmi edhe transaksionet bankare për secilin klient e cila njeherit edhe ka qene kërkesë e dosjes se tenderit. Po ashtu, Paneli Shqyrtues i sqaron AK-së se duhet të ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Në anën tjetër, autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - KK Prishtinë

1x1 OE - N.T.P“Aragonit-2” - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhi PAÇARIZI

